

**VENDIM**  
**Nr. 492, datë 21.7.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 48, DATË 27.1.2021, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR  
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT/RIFORCIMIT TË  
OBJEKTEVE NË ADMINISTRIM TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, NË  
BASHKITË DURRËS DHE LEZHË, DHE CAKTIMIN E SHËRBIMIT INFORMATIV  
TË SHTETIT SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 48, datë 27.1.2021, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i shtohet fondi në masën 1 965 695 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për rikonstruksionin/riforcimin e objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, të ndodhur në Bashkinë Lezhë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, të miratuar për vitin 2022.”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**